



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 4212/1 Prot.

Tiranë, më 3/4/2020

URDHËR

Nr. 88, Datë 3,4 2020

**“PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË PËRKTHIMEVE TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR NR. 9 “INSTRUMENTET FINANCIARE” (SNRF 9), TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 39 “INSTRUMENTET FINANCIARE” (SNK 39) SI DHE TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR NR. 7 “INSTRUMENTET FINANCIARE” (SNRF 7)”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e ndryshimeve të përkthimeve të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 9 “Instrumentet Financiare” (SNRF 9), të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 39 “Instrumentet Financiare” (SNK 39) si dhe të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 7 “Instrumentet Financiare” (SNRF 7).
2. Të gjitha standardet e mësipërme do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël që fillon më ose pas datës 01.01.2020.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

MINISTËR

Anila Denaj

